REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 193, datë 28.12.2017

PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE "KPMG ALBANIA" SH.P.K, PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2017, TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA" SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, të nenit 123, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si dhe të Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 "Për përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë audituese "KPMG Albania" sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare, për vitin financiar që mbyllet në 31.12.2017, të shoqërisë së sigurimit "Sigal Uniqa Group Austria" sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR **DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

Pajtim MELANI **Ervin KOÇI**